



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:234831

Datë: 24.01.2023

Numri i dokumentit: 03893426

PKR. Nr. 240/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Krimeve të Rënda, me Kryetarin e trupit gjykues, gjyqtarin Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Teuta Spahija, në çështjen penale kundër të akuzuarit M. H. nga Peja, i akuzuar për shkak se ka kryer veprë penale, *“Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”*, nga neni 366 par.1, të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti për krime të rënda, PP/I. Nr.297/2022, të datës 10.12.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 20.01.2023, në prezencë të Prokurorit të shtetit Ersan Qavolli, të akuzuarit M. A., me dt. 23.01.2023, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 24.01.2023, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M. A., i lindur me dt. ...në D., me vendbanim në Pejë rr. “M. M.” B/., lagjja P. H., i biri i M. dhe nënës F. e vajzërisë H., posedues i nr. tel. .../...-..., i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr., i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i R. Kosovës, **mbrohet në liri**,

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

- Nga muaji dhjetor i vitit 2021 e në vazhdimësi gjer me dt. 04.10.2022 rreth orës 09:40 në Pejë, lagjen P. H. rr. “M. M.” B/., mban në pronësi armë në shkelje me ligjin për armët nenin 37 par. 1 nën par. 1.1 dhe atë armën e llojit S.S, *tipi ...*, me nr. *serik ...*, si dhe *katërmbëdhjetë fishek të së njëjtës armë*, në atë mënyrë që, pasi të pandehurit me datën 11.12.2021 i skadon leja e armës, të cilën nuk e vazhdon fare dhe e njëjta automatikisht revokohet, ashtu që i njëjti edhe përkundër kësaj, e posedon pa leje gjer me datën 04.10.2022 kur edhe i sekuestrohet nga Policia e Kosovës,
- Me çka ka kryer veprën penale, **“Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”**, nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 8, 9, 10 par.1, 17 par.1, 21,38, 39 par.1, 40, 43 par.1 nen par. 1.3, 69 , 71, 72 par.1 pika 1.5, nenin 366 par.1 të KPRK-së, dhe nenit 245, 246, 359, 360, 361, 362, 365, 366 dhe 450 te KPPRK-se, të pandehurin M. H.e:

G J Y K O N

- Me dënim me gjobë në shume prej 600 (gjashtëqind) euro, e të cilin dënimi i njëjti ka për tu pagabuar ne afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij Aktgjykimi.
- Nëse i pandehuri dënimin me gjobe dështon, refuzon, apo nuk dëshiron ta paguan, i njëjti do ti zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur çdo dite qëndrimi ne burg shumen nga njëzetë (20) euro te gjobës.
- Obligohet i pandehuri në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale në shumë prej 30€ (tridhjetë) euro, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, shumën prej 50 (tridhjetë) €.
- Konform nenit 269 par. 3, të KPRK-së, të njëjtit i shqiptohet edhe dënimi plotësues:

KONFISKOHET - një (1) pistoletë e tipit S.S., tipi ..., me nr. serik, së bashku me katërmëdhjetë fishek të së njëjtës armë, dhe të njëjtat kanë për tu **URDHËROHET** qe te **SHKATËRROHET** pasi që aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/I Nr. 297/22 të datës 10.12.2022, kundër të akuzuarit M. H. nga P, i akuzuar për shkak se ka kryer veprën penale, “Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 par.1, të KPRK-së.

Gjykata me dt. 20.01.2023, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale, në të cilën kanë marrë pjese Prokurori i Shtetit, Ersan Qavolli, i pandehuri M. A..

Pas leximit të aktakuzës, nga ana e Prokurorit të shtetit, nën shenjen PP/I Nr. 297/22 të datës 10.12.2022 , në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata, ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë, kushtet, privilegjet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije e **pranon fajësinë**, për veprën penale, “Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 par.1, të KPRK-së, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës pa asnjë ndryshim, i vjen keq për veprimin e bërë.

Prokurori i Shtetit në lidhje me pranimin e fajësisë, nga ana e të pandehurit M.A., ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë, meqenëse ka mbështetje në shkresat e lëndës dhe i propozoj gjykatës që këtë pranim të fajësisë ta aprovon.*

Në vijim, gjykata duke shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata me Aktvendim procedural, e ka aprovuar pranimin e fajësisë, për veprat që i vihen në barrë, nga ana e të akuzuarit ngase pranimi i fajësisë gjen mbështetje edhe në provat vijuese: *Njoftimi i Policisë së Kosovës dt. 17.11.2022 nr. ref: ../-...-../...; Leja për lëvizjen me armë deponuar nga i pandehuri M. H. në këtë prokurori me dt. 14.11.2022; Fotografitë e armës së sekuestruar; Lista e armës dhe municionit të sekuestruar; Raporti i oficerit E. K. KPS ... dt. 04.10.2022; Raporti i policit S. H. c ID ... dt. 04.10.2022; Njoftimi i hetuesit H. B. dt. 04.10.2022; Leja për armë shenjëtarië DA1.....si dhe shkresa tjera në lëndë, dhe mbi këtë është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë, se i akuzuari ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë dhe për këtë është vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 326 par. 4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 248 par. 4, të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.*

Prokurori i Shtetit në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: *i propozon gjykatës që si rrethana lehtësuese ta merr pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethane rëndësuese në rastin konkret nuk ka gjet.*

I akuzuari M. H. ka deklaruar së: *me vjen keq që ka ndodhur, jam penduar shumë, këtë arme kam poseduar me leje por leja me ka skaduar dhe ka qene neglizhenca ime, nuk do të përsëritet me, i propozoj gjykatës që të me shqiptoj një dënim sa më të butë.*

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “*Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve*”, nga neni 366 par.1, të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të pandehuri ka ekzistuar dashja që veprat penale ta kryejë në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprat e kryera dhe e ka dëshiruar kryerjen e tyre.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Kryetari i trupit gjykues me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata për të akuzuarin, mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, ku si rrethanë lehtësuese mori sjelljen e tij gjatë gjykimit, ndjenjën e thellë mbi pendimin, ndërsa si rrethanë veçanërisht lehtësuese bazuar në dispozitën

ligjore të paraparë nenin 70 par.3 pika 3.10, 3.11 të KPRK-së, mori pranimin e fajësisë, keqardhjen e shfaqur, premtimin se më nuk do të bie ndesh me ligjin, pa dënushmerinë e mëparshme, ndërsa si rrethane renduese gjykata në rastin konkret nuk gjeti asgjë. Duke pasur për bazë të gjitha këto rrethana të përmendura në raport me të akuzuarin të njëjtës i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për shkak se dispozita e nenit 49 të KPRK-së, parasheh se dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilin është i paraparë dënimi me burgim deri në pesë vjet dhe për kryerësin e veprës penale për të cilin është paraparë dënimi deri në dhjetë vjet burgim, nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit, në rastin konkret i pandehuri ka kryer veprën penale nga neni 366 par.1 të KPRK-së, për të cilën parashihet dënim me gjobë deri 7500 euro apo dënim burgimi deri në pesë (5) vjet.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për zëvendësimin eventual e dënimit të shqiptuar me gjobe me dënim burgimi në rast se i pandehuri dështon apo refuzon ta paguan dënimin me gjobë u morr konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi për konfiskimin e armës e cila ka qenë objekt i veprës penale nga dispozitivi I, u morr konform nenit 366 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi për paguarjen e shpenzimeve procedurale, u morr konform nenit 450 par. 1, par.2 nën pika 2.6 të KPRK-së.

Vendimi për taksat e kompensimit të viktimave të krimit, u morr në bazë të qarkores për zbatimin e ligjit NR.05/L-36.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPRK-së.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.240/22 dt. 24.01.2023

Bashkëpunëtorja profesionale,
Teuta Spahija

Kryetari i trupit gjykues,
Dr.sc. Murat Hulaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.